

Abstrakt

Falja është atribut, të cilin Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton Presidentit. Shumica e Kushtetutave të botës faljen e konsiderojnë si një kompetencë që duhet të zotërohet nga Presidenti i Republikës.

Falja paraqet një akt i cili hartohet nga Shefi i Shtetit dhe nxirret në formë të vendimit (dekretit), me të cilin akt, personat e caktuar emër për emër lirohen plotësisht apo pjesërisht nga ekzekutimi i dënimit.

Në kuadër të procesit të faljes, marrin pjesë katër subjekte: i dënuari (familjarët e të dënuarit ose përfaqësuesi i autorizuar), Ministria e Drejtësisë dhe Presidenca (përfshihet Presidenti dhe Komisioni që formohet nga Presidenti).

Personi i Dënuar, nënkupton personin e dënuar me anë të një vendimi përfundimtar nga ndonjë gjykatë e Kosovës.

Personi i Dënuar, në Republikën e Kosovës, për të arritur deri tek falja, duhet të kalojë nëpër disa procedura. ‘Rrugëtimi’ i të dënuarit drejt faljes, rregullohet me Ligjin për Faljen dhe Rregulloren për Kriteret dhe Procedurat për Faljen e personave të dënuar.

Në këtë temë, nuk do të trajtohet vetëm rruga e të dënuarit drejt faljes por edhe do të analizohen kriteret dhe procedurat që i dënuari duhet ndjekur për të arritur deri tek falja.

Tema ‘E drejta kushtetuese e Presidentit për falje – Rasti i Kosovës’, paraqet një kontribut të analizës së rolit të Presidentit të Kosovës për dhënien e faljes së personave të dënuar.

Fjalët kyçe: Presidenti, Falja, Kërkesë, Personi i Dënuar, Ministria, Komisioni.